

DEFTERI I REGJISTRIMIT
TË SANXHAKUT TË SHKODRËS
I VITIT 1485

I

TIRANË 1974

AKADEMIA E SHKENCAVE E R.P. TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

**DEFTERI I REGJISTRIMIT
TË SANXHAKUT TË SHKODRËS
I VITIT 1485**

Paraqitja, hyrja, transliterimi,
përkthimi dhe komentet nga
SELAMI PULAHA

TIRANË, 1974

H Y R J E

Studimi i ndryshimeve social-ekonomike që ndodhën në tokat shqiptare me pushtimin osman të kryer gjatë shekullit XV përbën një nga detyrat kryesore në fushën e studimeve të historisë mesjetare shqiptare, sepse nëpërmjet tij do të mund të zbulohen rrënjët e asaj qëndrese të ashpër që i bëri populli shqiptar gjendjes së re jo vetëm në shekullin XV, por edhe në shekujt XVI-XVII dhe do të mund të kuptohet rruga historike që ndoqi në kushtet e reja populli ynë. Zgjidhja e kësaj detyre kërkon në radhë të parë botimin e materialeve dokumentare që pasqyrojnë politikën e ndjekur nga sunduesit e rinj osmanë ndaj klasës feudale vendase dhe ndaj fshatarësisë, nëpërmjet zbatimit të sistemit të timarit. Në këtë drejtim një hap të rëndësishëm përpara bëri historiani turk Halil Inalxhik me botimin e *Defterit të sanxhakut shqiptar të vitit 1431-32*,¹ që është një burim historik me vlerë për të njohur gjendjen e re të krijuar në Shqipërinë e mesme dhe jugore në gjysmën e parë të shekullit XV. Me qëllim që të zgjerojmë këtë kuadër edhe për krahinat e Shqipërisë veriore pas rënies së Shkodrës në vitin 1479, i vumë vëntes për detyrë të botojmë *Defterin e hollësishëm (mufassal) të regjistrimit të tokave dhe të popullsisë në sanxhakun e Shkodrës në vitin 1485*², deri tani i pabotuar dhe i pastudjuar.

Në arkivat turke, si në Arkivin e kryeministrisë në Stamboll (*Başvekâlet arşivi = BV.A.*) dhe në Arkivin e drejtorisë së përgjithshme të tapive dhe të kadastrës në Ankara (*Tapu ve Kadastro umum müdürlüğünün arşivi = TK.A.*) ruhen një pasuri e madhe burimesh lidhur me krahinat e Shqipërisë veriore nga fundi i shekullit XV dhe gjatë shekullit XVI. Nga këto burime më të rëndësishme janë:

1 — Defteri i hollësishëm (*mufassal*) dhe defteri i përmbledhur (*icmal*) i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485³.

2 — Fletët e regjistrimit të hollësishëm dhe të atij të përmbledhur të nahiëve të Pipërit, të Kuçit, të Hotit dhe të Kelmendit në vitin 1497⁴.

3) Defteri i timareve të Rumelisë i viteve 1529-36⁵.

4) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1582⁶.

1) H.Inalcik, *Suret-i defter-i, sancak-i arvanid*, Ankara 1954.

2) Başvekâlet arşivi, Tapu defterleri, *Defter-i mufassal liva-i Iskenderiye*, nr. 17. Më poshtë do ta citojmë vetëm me emrin: defter.

3) BV.A., Tapu defterleri, *Defter-i liva-i Iskenderiye*; nr.17 dhe nr.26 m.

4) BV.A., Tapu defterleri, *Defter-i liva-i Iskenderiye*, nr.17 shtojca në faqet 189-204; *Defteri liva-i Iskenderiye*, nr.26 m. Shih gjithashtu B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore, brdskih i malisorskih plemena*, Radovi naučnog društva BiH.II, Sarajevo 1954, f.165-220,

5) BV.A., Tapu defterleri, nr.367.

6) TK.A., defter nr.59.

5) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Dukagjinit i vitit 1571⁷.

6) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Dukagjinit i vitit 1591⁸.

Nga këto, zgjodhëm për botim defterin e hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 jo vetëm për faktin se ai paraqet regjistrimin e parë, të plotë, të kryer pas pushtimit, por edhe për arësyen se krahina e Shkodrës është një nga zonat e pakta në Ballkan, për të cilën kemi një dokument të tillë të rëndësishëm për periudhën para pushtimit osman, siç është *Kadastru venedikas i Shkodrës dhe regjistri i koncesioneve*⁹, që sjell të dhëna të hollësishme mbi pronësinë dhe marrëdhëniet feudale të sistemit të pronies në shekullin XV. Pra, duke patur për të njejtën zonë dy dokumenta të hartuara për të njejtat qëllime dhe të njejtit karakter për një periudhë të pandërprerë prej një shekulli krijohet mundësia për të ballafaquar dhe për të krahasuar gjendjen e periudhës së para pushtimit me atë pas pushtimit osman. Kjo lejon të ndriçohen për së afërmi disa aspekte të ndryshimeve që ndodhën me vendosjen e sistemit të timarit si dhe veçoritë e zbatimit të këtij sistemi në kushtet e veçanta të Shqipërisë.

Përveç regjistrimit të vitit 1485, defteri që po botojmë, ka në fund, si shtojcë, regjistrimin e hollësishëm të nahijeve të Pipërit dhe të Kelmendit të bërë në vitin 1497. Siç dihet, regjistrimin e përmbledhur (*icmal*) të këtyre nahijeve si dhe të nahijeve të Kuçit dhe të Hotit në vitin 1497, e ka botuar historiani jugosllav B. Gjurgjev¹⁰. Po përfshijmë në botim këtë shtojcë, sepse përmban të dhëna me interes për gjendjen dhe lëvizjet e malësorëve të Pipërit dhe Kelmendit, të cilat mungojnë në regjistrimin e përmbledhur.

Njoftimet e defterit në fjalë i përkasin një treve shumë të gjerë, që i kapërxen kufijtë e sanxhakut të Shkodrës. Në vitin 1485 ky sanxhak ndahej në katër kaza: të Shkodrës, të Podgoricës, të Pejës dhe të Bihorit. Kazatë ishin ndarë në njisi më të vogla administrative, në nahije:

Kazaja e Shkodrës ndahej në nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Këndejmë (Bregu veri-lindor i liqenit të Shkodrës), të Bregut të Përtejme (Bregu jugë-perendimor i liqenit të Shkodrës), të Krajnës, të Merkodit, të Maleve të Shestanit dhe të Maleve Mjet (zona e Shëngjinit).

Kazaja e Podgoricës ndahej në nahijet e Podgoricës, të Zhabjakut, të Kuçit, të Bjelopavliqit (Palabardhit), të Pipërit, të Maleve të Hotit, të tokave të Petri-shpanit (tokat e Pjetër Spanit – Pulti i sotëm, Shala, Shoshi, Nikaj-Merturi) dhe të Kelmendit (pas vitit 1497, kur Kelmendi njohu sundimin osman).

Kazaja e Pejës ndahej në nahijet e Pejës, të Altun-ilisë (zona midis Gjakovës-Junikut-Tropojës) dhe të Suhogërlës.

Kazaja e Bihorit ndahej në nahijet e Komninit, të Komaranit, të Plavës, dhe të Izlarjekës.^x

Përveç këtyre, në regjistrim janë përfshirë dhe një pakicë fshatrash nga nahijet e Vuçiternit, të Prishtinës, të Prizrenit, etj., që bënë pjesë në sanxhaqet e Vuçiternit dhe të Prizrenit.

7) BV.A., Tapu defterleri, nr.499.

8) TK.A., defter nr.63.

9) F.Cordignano, *Catasto veneto di Scutari e Registrum Concessionum 1416-1417*, v.I-II, Scutari 1940, Roma 1942; Joseph Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Tomus VIII, IX, München 1970.

10) B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore...*, në Radovi naučnog društva BiH. II, Sarajevo 1954 f.165-220.

^x) Në Sanxhakun e Shkodrës përveç tokave shqiptare ishin përfshirë edhe toka me popullsi sllave.

Siç vërehet në këtë pasqyrë, sasia e feudeve të krijuara në sanxhakun e Shkodrës më 1485 është e pakët. Shumica e tyre gjendeshin në kazanë e Pejës të pushtuar me kohë. Kjo dëshmon se atje sistemi i timarit kishte bërë hapa përpara në vendosjen e tij të plotë. Shumë më i pakët është numri i feudeve në kazatë e Shkodrës dhe të Podgoricës, po të kihet parasysh teritori i gjerë i këtyre krahinave. Sasia prej 35 timaresh dhe 1 ziameti që formoheshin me të ardhurat e vjela nga fshatarësia e krahinave në fjalë, tregon se sistemi i timarit nuk kishte fituar një shtrirje të gjerë.

Për këtë dëshmon gjithashtu fakti se zonat malore të krahinës së Shkodrës dhe të Podgoricës nuk ishin vënë nën pushtetin dhe qeverisjen e spahijve, përfaqësuesve direktë të administratës osmane në tokat e timareve të tyre. Viset malore si Plava, Kuçi, Bjelopavliqi, Hoti, Pipëri, Shestani, Merkodi dhe Krajna ishin përfshirë në hassin e sanxhakbeut²⁷, kurse Pulti i sotëm, Shala, Shoshi, Nikaj-Merturi (*Ptrishpan ili*), si një unitet më vehte, bënë pjesë në ziametin e Mehbeut, të birit të Kasapit²⁸.

Moszbatimi në thellësi i sistemit të timarit dëshmohej edhe nga pesha e pakët që zinin të ardhurat e shpërndara si timare, në shumën e përgjithshme të të ardhurave nga detyrimet që jepte fshatarësia. Timaret nuk përfshinin më shumë se 167.450 akçe, dmth 1/4 e sasisë së përgjithshme të rentës, kurse hassi i sanxhakbeut dhe ziameti i Mehmet beut kishin 450.315 akçe të ardhura, dmth afro 3/4 e sasisë së përgjithshme të detyrimeve, sasi që afërsisht arrinte në 617.765 akçe²⁹.

Sunduesit osmanë e kishin të vështirë të zbatonin sistemin e timarit në malësitë, sepse një gjë të tillë nuk e lejonin disa faktorë si niveli i ulët i zhvillimit të marrëdhënieve feudale, që lidhej me karakterin malor të vendit dhe mungesën e tokave të punueshme, qendresa e malësorëve kundër pushtimit etj. Këtu osmanët u gjendën para disa kushteve të veçanta: diferencimi ekonomik shumë i pakët në gjirin e shoqërisë malore, mungesa e një klase feudale të brendshme në kupimin e plotë të fjalës, nuk u jepte atyre mundësi të krijonin një mbështetje shoqërore, duke gëlltitur në klasën sunduese osmane elementë feudalë vendës, siç patën vepruar gjatë nëpërmjet institucioneve të tyre feudale. Për shkak të organizimit shoqëror mbi bazën e fisit ose katunit, dhe të mbisundimit të pronësisë së përbashkët të tokës, osmanët ishin të detyruar të mospraktikonin ndarjen e tokave me tapi dhe, për rrjedhim, të linin në fuqi pagimin e detyrimeve në formë të prerë. Renta mbeti përsëri në formën e një rente shtetërore, fikse, por që tashmë ndryshoi emrin duke u quajtur hass. Zotëruet i saj u bë kryesisht sanxhakbeu, përfaqësuesi i pushtetit qendror, në vend të kryezotëve feudale të mëparshëm, Spanëve dhe Dushmanëve.

Moszbatimi i normave të zakonëshme të timarit, që rridhnin nga vënia në jetë e parimit të pronës mirie, si në drejtim të rentës feudale ashtu dhe në drejtim të vartësisë të fshatarve ndaj spahijve, ruajtja e pandryshuar e gjendjes së para-pushtimit, na bindin se cilësimi i rentes së malësorëve si hass, feud karakteristik

27) defter, f.266-286 (Plava), 295-299 (Kuçi), 300-302 (Bjelopavliqi), 303-306 (Hoti), 308-313 (Pipëri), 321-324 (Shestani), 325-327 (Merkodi), 328-330 (Krajna).

28) defter, f. 334-350.

29) Kjo shumë përfshin vetëm të ardhurat nga detyrimet që nxirreshin prej popullsisë së kazave të Shkodrës dhe të Podgoricës, pa të ardhurat e hasseve perandorake nga doganat, peshkimi, monopoli i kripës etj.

thela, Fshajani, Nika, të nahijes së Pejës; Kaliq, Kolshiq, Rogam të nahijes së Altun-ilisë; Shekullar të nahijes së Komninit etj¹⁴⁶.

Në vendbanime të tilla të Pejës gjejmë banorë të cilët thajse të gjithë mbanin antroponimi sllave. Kjo tregon se aty ndikimi i simbiozës dhe i faktorëve politikë-fetarë serbë ishte më i madh se në krahinat e tjera.

Nga ana tjetër në zonat e brendshme të sanxhakut, si p.sh. në krahinat e kazasë së Shkodrës dhe në nahijen e Petrishpanit, ndeshim vendbanime me toponimi shqipe që kanë banorë me antroponimi sllave ose shqiptaro-sllave, por këta janë në një sasi më të pakët në krahasim me banorët që mbanin emra tipikë shqiptarë.

Prania e shqiptarëve në zonat kufitare dëshmohet edhe nga disa të dhëna të tjera të karakterit gjuhësor. Përveç banorëve me emra shqiptarë ndeshim aty edhe banorë me emra orthodoxë ose me emra sllavë të përshtatur gjuhës shqipe si Lazër, Lazor për Lazar; Gjergj për Gjorgj, ose emra sllavë të dhënë nga regjistruesi në trajtën e shquar me nyjat e shqipes *i, a (ja)*, si p.sh. Dimitri për Dimitr, Petri ose Pjetri për Petr; Aleks për Aleks; Radi për Rad; Gjorgji për Gjorgj; Rajkoja, Vojkoja, Vojnoja, Dragoja, Vukja, Bozhja, Vladoja për Rajko, Vojko, Vojno, Drago, Vuk, Bozha, Vlado.

Në nahijet që përfshinin toka në jugë-perëndim të liqenit të Shkodrës, si në nahijet e Krajnës, të Maleve të Shestanit dhe të Merkodit, ku pjesën dërmuese të popullsisë e përbënin shqiptarët, ndeshim krahas antroponimisë thjesht shqipe edhe emra sllavë të përshtatur shqipes nëpërmjet prapashtesave të saja. Në këtë zonë, veçanërisht në nahijen e Merkodit, gjejmë të përdorur gjerësisht në emrat e kryefamiljarëve prapashtesën zvogëluese *z*, së bashkë me nyjen shquese *a*. Kjo vërehet jo vetëm në emrat thjesht shqiptarë si Malza për Mal, Nikëza për Nika, Dukëza për Duka, Doroza për Doro, Kalza për Kala, Kolza për Kola, Lekëza për Leka, Burza për Burë etj.; por edhe në emra sllavë si Ivza për Iva, Pejoza për Pejo, Gjuroza për Gjuro, Miloza për Milo, Dabza për Daba, Mladoza për Mlado, Cvetoza për Cveto, Groboza (Gruboza) për Grubo, Zhivza për Zhivo, Dragoza për Drago etj. Emra sllavë me prapashtesa të tilla nuk i ndeshim rëndom në antroponiminë e krahina ve të tjera fqinje ose në krahinat e Malit të Zi, me përjashtim të nahijes së Cërnicës, fqinje me Merkodin. Të dhënat e mësipërme flasin në favor të tezës së popullsisë e atjeshme ishte një popullsi shqipfolëse.

Fenomeni i përshtatjes së emrave sllavë gjuhës shqipe pati një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë, gjë që kuptohet nga numri jo i vogël i fshatrave të krahinave skajore të Sanxhakut, ku ndeshet kjo dukuri. Ky është një fakt që na bind se simbioza shqiptare-sllave nuk ishte zhvilluar në një rajon të ngushtë, por në një territor të gjerë që fillonte në perëndim me krahinën e Merkodit dhe të Krajës, dhe vazhdonte në veri dhe verilindje në krahinat e Zhabjakut, të Podgoricës, të Pipërit, të Bjelopavliqit, të Plavës, të Pejës, të Suhogërlës etj. Këto ishin zonat e kontaktit midis të dy popullsive në shekullin e XV.

Mungesa e onomastikës shqiptare në nahijet Komninit, të Komaranit, të Izlarjekës le shteg të mendohet se onomastika sllave i përgjigjej këtu një popullsi sllave, kurse në zonat ku ndeshim edhe onomastikë shqiptare si në nahijet e Zhabjakut, të Podgoricës, të Plavës, të Pejës dhe të Suhogërlës, antroponimia sllave nuk tregon gjithmonë elementin sllav. Siç e thamë dhe më lart, faktorët politikë-fetarë ndikuan gjerësisht në huajtjen e antroponimisë sllave nga ele-

146) defter, f. 311-313; 295-299; 134, 164-165; 470-471, 42-43, 7-8, 52, 121, 232, 33, 9; 393-395, 398.

PASQYRA E LËNDËS

- | | |
|--|----------------|
| 1) Hasset e mirlivait në nahijet e ndryshme. | 210-332 * |
| 2) Ziameti i [Mehmedit], të birit të Kasapit në nahijen e Petrishpanit dhe në nahijet e tjera. | 334-348 |
| 3) Ziameti i të famshmit Hysen bej Çashnegjirit. | 350-356 |
| 4) [Ziameti] i nahijes Altun-ili. Pjesa e Shuxhaa beut dhe pjesa e Mirza beut | 358-399 |
| 5) Ziameti i Suhagërlës. | 402-413 |
| 6) Ziameti i Deçanit. | 414-421 |
| 7) Ziameti Joshanicave. | 422-426 |
| 8) Ziameti Zakovik. | 426-428 |
| 9) Ziameti i Hamza beut. | 429-437 |
| 10) [Timaret] e spahijve të nahijeve të Pejës (Ipek). | 437-473, 1-118 |
| 11) [Timaret] e spahijve të nahijes së Shkodrës (Iskenderije). | 120-165 |
| 12) [Timaret] e mbrojtësve të Drishtit (Dërgoz). | 166-177 |
| 13) Vojnukët e sanxhakut. | 178-188 |
| 14) [Regjistrimi i hollësishëm i nahijeve të Piperit dhe të Kelmendit në vitin 1497] | 189-204 |

*) Po japim faqet e dokumentit në origjinal.

Fshati Sila

Ugjlësja, i biri i Bërçinit

shtëpi: 1

shuma: fshatra 15, manastire 1, shtëpi 171, të veja 13, të ardhura 12.512

(266)

VILAJETI I PLAVËS, NGA HASSET E SANXHAKBEUT.

Fshati Ribar, hass i të sipërpërmëndurit.

Ilia, i biri i Vukashinit
Brata⁶⁷, i biri i Kallogjerit
Vuçeta, i biri i Prebilit
Vukashini, i biri i Pribos
Vuka, i biri i Bogdanit
Pava, i biri i Popit
Nikolla, i biri i Popit
Vukaçi, i vëllai i tij
Vuçrini, i vëllai i tij
Vukashin Bolini
Vuku, i vëllai i tij
Stoja, i vëllai i tij
Bogosavi, i biri i Mladenit
Nikolla, i biri i tij
Radiçi, i biri i Vukashinit
Radosavi, i vëllai i tij
Radosna, i biri i Bogdanit
Vukashini, i biri i Radmilit
Vukashini, i biri i Radiçit
Vukashini, i biri i Radashinit
Radivoi, i biri i Stojës
Ivani, i vëllai i tij
Nikolla Gjurashini
Vuku, i biri i tij
Radosna, i biri i Radbalit
Radaku, i biri i Dabzhivit
Radiçi, i vëllai i tij
Stepani, i biri i Radsalit
Vlajko, i biri i Radiçit
Pop Novaku
Vukashini, i biri i Vladisalit
Bolja⁶⁸, i vëllai i tij

Rajko, i vëllai i tij
Radosna, i biri i Vukotës
Vuksani, i vëllai i tij
Bërzani, i biri i tij
Vuku, i biri i Vukashinit
Stepan Popi
Radonja, i biri i Bozhidarit
Gjurashini i vëllai i tij
Radivoi, i vëllai i tij
Stepani, i biri i Nikollës
Radosavi, i biri i Vlajkos
Stepani, i biri i Radiçit
Rajko, i biri i Drazhinit
Deja, i biri i Stepës (Stepa)
Vuku, i biri i Pricës
Ivani, i biri i Radiçit
Vukça, i biri i Radiçit
Plaku, i biri i Rajkos
Vuku, i vëllai i tij
Vuksani, i vëllai i tij
Vukashini, i biri i Radiçit
Ivashi, i vëllai i tij
Vlajko, i biri i Radovanit
Radiçi, i biri i Brankos
Oliviri, i biri i Radiçit
Vuku, i biri i Radbalit
Kragoi, i vëllai i tij
Todori, i biri i tij
Vuçrini, i vëllai i tij
Stepani, i biri i Vukashinit
Vukosavi, i biri i Radit
Vuksani, i biri i Vladisalit

67) Në këtë rast është shkruar pa shënjat diakritike براته . Në faqen 298 lexohet qartë

Brata براته

68) Mund të lexohet edhe Tolja — توليه

(267)

Bolashini, i biri i Slavkos
Dobrosavi i biri i Vladisalit
Vlajko, i biri i Bogdanit
Radosna, i vëllai i tij
Dobrani, i biri i Grubaçit
Stoja, i biri i Stepanit
Vojnoi, i biri i Radit
Vukashini, i biri i Novakut
Dejani, i biri i Bojanit
Radiçi, i biri i tij
Radsavi, i biri i Bojkos
Radonja, i vëllai i tij
Vukosa, i biri i tij
Zhivko, i vëllai i Slavit
Radiçi, i biri i Raçës
Stepani, i biri i Rajkos
Vukota, i vëllai i tij
Vukashin Brajani
Nikolla, i vëllai i tij
Rajko, i biri i Vuksanit
Bozhidari, i biri i Vukotës
Miomani, i biri i Mirit
Novaku, i biri i Radit
Dobrashini, i biri i Bozhidarit
Radiçi, i biri i Prebilit
Radosna, i vëllai i tij
Radenko, i biri i Brankos
Vasili, i vëllai i tij
Dujçini, i biri i tij
Radosna, i biri i Vishës
Petriçko, i biri i Priçës
Radiçi, i biri i Miles
Radsavi, i biri i Brankos
Ugjlesha, i biri i Stepës
Vuku, i vëllai i tij
Rajani, i vëllai i tij
Novak Domezeti⁶⁹

Dimitrashi i vëllai i tij
Ugjlesha, i vëllai i tij
Stepko, i biri i Brankos
Vuksani, i biri i Olivirit
Oliviri, i biri i tij
Tërbaçi, i vëllai i tij
Vuçrini, i biri i tij
Radiçi, i vëllai i tij
Mirosavi, i biri i Prebilit
Mioko, i biri i Brajanit
Radivoi, i vëllai i tij
Rasha, i biri i Radashinit
Vuku, i biri i Radit
Dajça, i vëllai i tij
Stoja, i vëllai i tij
Vladisavi, i biri i Vukut
Marko, i vëllai i tij
Bogdani, i biri i Radiçit
Novaku, i biri i Mirosalit
Radosavi, i vëllai i tij
Vukosavi, i vëllai i tij
Bransavi, i vëllai i tij
Radsavi, vëllai i tij
Nikolla, i biri i Radiçit
Nikolla, i biri i Vukotës
Radonja, i vëllai i tij
Nikolla, i biri i Radiçit
Prenku, i biri i Vukçës
Bransavi, i biri i Gjurkos
Nikolla, i vëllai i tij
Vuçrini, i biri i tij
Dimitri, i vëllai i tij
Noka, i biri i Vukashinit
Lekaçi, i biri i Kosanit
Radonja, i biri i Bogdanit
Novaku, i biri i Tihosavit
Vojiça, i biri i Radiçit

(268)

Vukashini, i vëllai i tij
Miladini, i vëllai i tij
Bozhidar Bankaliqi
Radiçi, i biri i Mirkos

Visha, i biri i Gjurashinit
Novaku, i biri i Slavkos
Gjura, i biri i Stojës
Nokaçi, i biri i Vukçës

69) Në këtë rast është shkruar pa shënjat diakritike: دومهزت Në faqen 269 është shkruar në formë të plotë Domezet دومهزت

Radiçi, i biri i Radit
 Pop Stepani Branko Mirko
 Vuku, i biri i Radiçit
 Radosna, i biri i Radsalit
 Beladini
 Radiçi, i biri i Vljakos
 Vuku, i biri i Breshalit
 Novaku, i vëllai i tij
 Andrija, i biri i Mirosalit
 Bozhidari, i vëllai i tij
 Stepani, i biri i Prebilit
 Radonja, i biri i Radovanit
 Radosna, i biri i Radiçit
 Jovani, i biri i Vukosalit
 Vuksani, i biri i Breshalit
 Radiçi, i biri i Vuksanit
 Radosavi, i biri i Brankos
 Stepani, i biri i Vukçës
 Bozhidari, i biri i Brankos
 Jovani, i biri i Bozhidarit
 Andrija, i biri i Vukashinit
 Nikolla, i biri i Vukut
 Grubaçi, i biri i Brishalit
 Zhivko, i biri i Prinkut
 Radonja, i biri i Radosnës
 Marini, i vëllai i tij
 Radiçi, i biri i Vukotës
 Vukosavi, i biri i Brankos
 Radiçi, i biri i Radsalit
 Radonja Domezeti
 Radosna Kotasi⁷⁰
 Radiçi, i biri i Vukashinit
 Gjurashini, i biri i Bozhidarit
 Vuçrini, i biri i Radiçit

(269)

Bolashini, i biri i Radiçit
 Radoslav Gropça⁷¹
 Radonja, i biri i Jovanit
 Beladini, i biri i Stepanit
 Vukashini, i biri i Vuksanit
 Radsavi, i biri i Bogosalit
 Stepani, i biri i Bogdanit
 Vukosav Domezeti
 Brensavi, i biri i Stojës

70) Leximi është jo i sigurtë: قوباس Mund të lexohet edhe Konasi, Kobasi, Kopa-
 pas — قوناس، قوباس، قوباس

71) Leximi nuk është i sigurtë غروپچه Mund të lexohet edhe Grojça, Gronça — غروپچه

Pljaku, i biri i Radivoit
 Todori, i biri i Vladimirit
 Vukiçi, i biri i Radivoit
 Preku, i vëllai i tij
 Stepani, i biri i Vukashinit
 Radaku, i vëllai i tij
 Vukosavi, i vëllai i tij
 Stepani, i biri i Vladisavit
 Bosa, i biri i Brosit
 Vukça, i biri i Rajanit
 Brisavi, i vëllai i tij
 Radiçi, i vëllai i tij
 Bogdani, i biri i Radiçit
 Petri, i biri i Andrijës
 Grubaçi, i biri i Breshalit
 Vuksani, i biri i Vladimirit
 Vuksani, i biri i Radivoit
 Novaku, i vëllai i tij
 Ivani, i biri i Bozhidarit
 Rashko, i biri i Radiçit
 Stepani, i biri i Radlës
 Vuksani, i biri i Miles
 Bozhidari, i vëllai i tij
 Dimitri, i biri i Gjorgjit
 Llazëri, i biri i Prenkut
 Gjoni, i biri i Radiçit
 Bojko, i biri i Prepjas
 Novaku, i biri i tij
 Vljako, i biri i Radiçit
 Radivoi Kora (Kura)
 Radosavi, i biri i tij
 Radosna, i biri i Vukashinit
 Radivoi, i vëllai i tij
 Todori, i biri i Vukashinit

Pava, i biri i Brankos
 Branko, i biri i Radulit
 Stepani, i biri i Dimitrit
 Radosna, i biri i Brankos
 Petri, i biri i Gjurrës
 Vladisavi, i biri i Gjurashit
 Radsavi, i biri i Radiçit
 Jovani, i biri i tij
 Gjurashini Siromah

Radosna, i biri i Radiçit
 Radiçi, i biri i Radovanit
 Stepani, i biri i Mirosalit
 Grubaçi, i vëllai i tij
 Vuku, i biri i Boljas
 Vukashini, i biri i Leçit
 Radiçi, i biri i Radsalit
 Vuku, i vëllai i tij
 Oliviri, i vëllai i tij
 Rahoi, i vëllai i tij
 Jovani, i vëllai i tij
 Stepani, i vëllai i tij
 Mladeni, i biri i Radiçit
 Gjuraçi, i biri i Stepës
 Vukota, i biri i Pljakut
 Radonja, i biri i Brenshalit
 Bogdani, i biri i Stojës
 Radonja, i biri i Vuksanit
 Bozhidari, i biri i Vukashinit
 Mihajlo, i vëllai i tij
 Radonja, i biri i Bojkos
 Bozhidari, i biri i Bozhiçit
 Nikavaçi, i biri i Vojnojës
 Radosavi, i biri i Vukashinit
 Gjuraçi, i biri i Pokrajaçës (Pokrajaça)

Radshi, i vëllai i tij
 Rako, i vëllai i tij
 Gjuraçi, i biri i Prebilit
 Bozhidari, i vëllai i tij
 Dimitri, i biri i tij
 Stepani, i biri i tij
 Bogdani, i vëllai i tij
 Vukosavi, i biri i Radivoit
 Pop Jovani
 Bojko, i biri i Stepës
 Bozhidari, i vëllai i tij
 Gjuraçi, i biri i Pljakut
 Novak Domezeti
 Bransavi, i biri i Rajkos
 Vukashini, i vëllai i tij
 Radiçi, i biri i Prebilit
 Radovani, i biri i Bogdanit
 Vukosavi, i biri i Vukotës
 Bogovaçi, i biri i Çirqës (Çirqa)
 Todori, i biri i Bogdanit
 Radashini, i biri i Radiçit
 Miraku, i biri i Mirosalit
 Bojça, i biri i Petkos
 Bojko, i biri i Stepanit
 Radosavi, i biri i Dobranit

shtëpi, ispenxhe
 284 7100

(270)

gruë barrë 150 4500	thekër barrë 138 2720	elb barrë 47 752	tagji barrë 90 1260	mel barrë 33 660	lini 420	[taksa e] perimeve 310
[taksa e] bletëve 280	mullinj të rajave: 4 120		mullinj të rajave: 4 65		taksa e barit 1420	
taksa e druve 568	bidati i derrave 184					

Nijabeti i vilajetit, taksa e gjerdekut, badihvatë dhe xhyrmi xhinajeti 2474

shuma 22.828

Fshati Gusinje^x, varet nga ajo, i hassit të sanxhakbent.

Vojnuko, i biri i Ivanit
 Pjaku, i vëllai i tij
 Petri, i biri i Obradit
 Nova, i biri i Bezhanit
 Radosna, i vëllai i tij
 Vuku, i biri i Radiçit

Mladini, i vëllai i tij
 Vukashini, i biri i Radonjës
 Gjuraçini, i vëllai i tij
 Radonja, i biri i Dobrivoit
 Pljaku, i vëllai i tij
 Gjuraçini, i vëllai i tij

Vojhina, i biri i Gjurashinit
Andrija, i biri i Stepanit
Radaku, i biri i Bozhidarit
Andrija, i vëllai i tij
Vukosavi, i vëllai i tij
Vuksani, i biri i Brankos
Vukosavi, i vëllai i tij
Dabzhivi, i vëllai i tij
Vuksani, i vëllai i tij
Nikolla, i biri i Vlojës (Vloja)
Vuku, i biri i Çapës (Çapa)
Bozhidari, i vëllai i tij
Gjura, i vëllai i tij
Stefani, i biri i Lazërit
Radonja, i biri i Prebilit
Vuku, i vëllai i tij
Radiçi, i biri i Bozhidarit
Nikolla, i vëllai i tij
Milobrani, i biri i Pavlit

(271)

Vuku, i biri i Vukashinit
Nikolla, i biri i Novakut
Radiçi, i biri i Mladenit
Stepani, i vëllai i tij
Jovani, i biri i Radovanit
Bozhidari, i biri i Radonës
Stepani, i biri i Gjurashinit
Bozhidari, i biri i Vukashinit
Gjura, i vëllai i tij
Vuku, i vëllai i tij
Ivko, i biri i Dresit
Nova, i biri i Vuçrinit
Nikolla, i biri i Bozhidarit
Vuku, i biri i Shashatit
Gjuraqi, i vëllai i tij
Dejani, i vëllai i tij
Radivoi, i biri i Nues ⁷²
Radonja, i biri i Vuçrinit
Vuçrimi, i vëllai i tij
Vuku, i biri i Nikës (Nika)
Vuku, i biri i Gjorgjit
Radiçi, i biri i Nikës
Nikaçi, i biri i Gjurës
Vuçko, i biri i Bozhidarit
Petko, i biri i Vukashinit
Vuçeta, i biri i Vuksanit

Gjura, i vëllai i tij, Mladeni i vëllai i tij
Mioko, i biri i tij
Radsavi, i vëllai i tij
Vuku, i biri i Popit
Jovani, i biri i Brankos
Vuksani, i biri i Nikollës
Gjura, i biri i Bozhidarit
Vukashini, i biri i Gjurashinit
Rashko, i biri i Ivanas
Gjura, i vëllai i tij
Nikolla, i biri i Stojes
Nikolla, i biri Andrijës
Radiçi, i vëllai i tij
Bransavi, i biri i Dobroit
Ivani, i biri i Rajçinit
Braçi, i biri i Gjurës
Vukosavi, i biri i Mladenit
Buda, i biri i Vujës (Vuja)
Novaku, i vëllai i tij

Stepani, i vëllai i tij
Stepani, i vëllai i tij
Bojko, i biri i Andrijas
Radiçi, i biri i Mladenit
Radla Siromah
Radosavi, i vëllai i tij
Radiçi, i biri i Vuçrinit
Vukça, i biri i Radsalit
Todori, i biri i Rajkos
Oliviri, i biri i Vukshës
Rajko, i vëllai i tij
Gjura, i vëllai i tij
Radiça, i vëllai i tij
Godaçi, i biri i Novakut
Dimitri, i biri i Stepanit
Vukota, i biri i Rashkos
Vladisavi, i biri i Radinës (Radina)
Andrija, i biri i Vukashinit
Gorajini, i biri i Radsalit
Vlačko, i biri i Radashinit
Mile, i biri i Andrijës
Petko, i biri i Bozhidarit
Vuku, i biri i Prebilit
Nina (Nine), i biri i Bozhidarit
Radiçi, i biri i Nues
Petri, i biri i Dimitrit

72) Lexim jo i sigurtë نوه . Mund të lexohet edhe Nova.

Vuçko, i biri i Gjurës
 Petri, i biri i Radiçit
 Oliviri, i biri i Dajçës
 Gjuraqi, i biri i Godaçit
 Bojko Siromah
 e veja Vojsava
 e veja Stoja

Radashi, i biri i Nikshës (Niksha)
 Vuksani, i biri i Dobroit
 Bladi, i biri i Gjurashinit
 Vukça, i biri i Stajkos
 Miloi Oliviri
 e veja Vukosava
 e veja Deboja

shtëpi 96	beqarë 21	të veja 4	ispenxhe 2824	grurë barrë 30 900	thekër barrë 10 200	elb barrë 24 304
mel barrë 14 380	tagji barrë 67 938					

(272)

lini 160	[taksa e] bletëve 76	mullinj të rajave: 3 90	[taksa e] perimeve 76
bidati i derrave 120	taksa e barit 460	taksa e druve 184	shuma 6692

Fshati Trepç^x, varet nga ajo; hass i të sipërpërmendurit.

Bojça, i biri i Radonjës
 Vidaku, i biri i Radsalit
 Radulko, i biri i Ralinit
 Nikolla, i biri i Bozhidarit
 Radsavi, i biri i Bogdanit
 Bogdani, i biri i Marjes (Marja)
 Radiçi, i biri i Kabaljes (Kabalja)
 Stepa, i biri i Vljakos
 Vuk Novaku,
 Branko, i vëllai i tij
 Gjura, i biri i Prebilit
 Radsav Nugjini
 Stojko Vukosavi
 Radiç Raku
 Radosna Radonja
 Niksha Bratuli
 Stepani, i biri i Brankos
 Gjura Bratuli Andrija Novaku
 Preku Radiçi e veja Ermenika

Vuku, i vëllai i tij
 Radosna, i vëllai i tij
 Tomasi, i biri i Radsalit
 Mirça, i biri i Bratulit
 Nikolla, i biri i Gjonashit
 Bozhidari, i biri i Breshalit
 Vuku, i biri i Petkos
 Vladisav Radovani
 Gjurashini, i vëllai i tij
 Gjoni, Siromah
 Vukashini, i biri i Radenkos
 Margjini, i biri i Nikollës
 Gjuriça, i biri i Vukotës
 Radiç Vuku Radiç Prepja
 Pop Nikavaçi Rasha Marini
 Vukosav Bogdani
 Vljako, i biri i Rashës
 Bogosav Radovani
 e veja Stosava

shtëpi 37	beqarë 3	të veja 2	ispenxhe 1012	grurë barrë 15 450	thekër barrë 9 180	elb barrë 5 80
mel barrë 5 100	tagji barrë 10 140		mullinj të rajave; 3 45	lin 40i	[taksa e] perimeve 40	

[taksa e] bletëve	bidati i derrave
34	15

(273)

taksa e barit	taksa e druve	shuma 2395
185	74	

Fshat i Vojhinino, varet nga ajo; hass i të sipërpërmendurit.

Radonja, i biri i Volës (Vola)	Rada, i biri i Gjures
Milashi, i biri i Mençkos	Mirosavi, i biri i Gikut (Gikos)
Bojko, i biri i Gjureshinit	Dimitrashi, i vëllai i tij
Radonja, i biri i Radiçit	Gjura, i vëllai i tij
Radiçi, i biri i Buzatit (Bozat)	Radenko, i vëllai i tij
Vidaku, i biri i tij	Petri, i biri i Gjuriçit
Nikolla, i biri i Radiçit	Radonja, i biri i Mdosit
Stepani, i biri i Radakut	Vuksani, i biri i Strojës
Miloshi, i vëllai i tij	Gjura, i biri i Grubaçit
Radosavi, i biri i Radinit	Pop Vladisavi
Vuksani, i biri i Novakut	Radsavi, i biri i Vukotës
Vukça, i biri i Vuçës (Vuça)	Radosna, i biri i Prebilit
Radosavi, i biri i Mirosalit	Vukça, i biri i Miçulës (Miçula)
Nikolla, i vëllai i tij	Radiçi, i biri i Radmanit
Bojko, i biri i Volës	Radosna Siromah
Prebili, i biri i Novakut	Vukosavi i biri i Nikollës
Zhivko, i vëllai i tij	Dabzhivi Siromah
e veja Belosava, e veja Stoja	e veja Todora
e veja Sturja	Vladisavi, i biri i Gjureshinit
Radosavi, i biri i Volës	Radashin Govedar
Vukça Beloqanini	Gjureshin Kobeti (Kubeti)

shtëpi	të veja	ispenxhe	grurë	thekër	elb	mel
39	4	999	barrë 4	barrë 13	barrë 5	barrë 5
			380	260	80	100
tagji	lini	[taksa e] bletëve	mullinj të rajave: 2		[taksa e] perimeve	
barrë 14	50	65	30		54	
196						
bidati i derrave	taksa e barit	taksa e druve	shuma 2507			
20	195	78				

(274)

Fshati Kirushova^x, varet nga ajo; hass i të sipërpërmendurit.

Dabzhivi, i biri i Dragashit	Vuku, i biri i Margjinit
Rasha, i biri i Bulkut	Vlajko, i vëllai i tij
Vukashini, i biri i Radonës	Vukota, i biri i Radonkos
Petko, i biri i Slavkos	Jovani, i biri i Priçës

Radosavi, i biri i Stojës
 Radonja, i biri i Vuçrinit
 Radosavi, i biri i Raçës
 Nikolla, i biri i Rashës
 Radosav Vdguli
 Pop Radivoi
 Bozhidari, i biri i Bojkos
 Vukashini, i biri i Radhos
 Vukosavi, i biri i Nikollës
 Stepiani, i biri i Gjurashinit
 Vukosavi, i biri i Vukashinit
 Gjura, i vëllai i tij
 Ivani, i biri i Margjinit
 Raposh (Reposh) Siromah
 Pribo, i biri i Priçës
 Leka, i biri i Romiçit
 Dabzhivi, i biri i Gjurashinit
 Zagraçi
 Vuça, i biri i Gjurës
 Bojko Siromah
 Nikolla, i biri i Gjurashinit
 e veja Petrina
 e veja Vishosava

Radonja, i biri i Vladsalit
 Radonko, i biri i Gjurkos
 Lekaçi, i biri i Romiçit (Rumiçit)
 Volja, i biri i Gjurashinit
 Vuksani, i biri i Bogosalit
 Pribo, i biri i Gjorgjës
 Milashi, i biri i Gjorgjit
 Gjura, i biri i Stepës
 Radiçi, i biri i Radsalit
 Lekaçi, i biri i Stepkos
 Nova, i biri i Radiçit
 Nikaçi, i biri i Dabzhivit
 Vukça, i biri i Bozhidarit
 Nikolla, i biri i Radonjës
 Stepiani, i biri i Gjurashinit
 Boro, i biri i Nikaçit
 Stepiani, i biri i Radjas
 Petri, i biri i Lazërit
 Andrija Koçano
 Bozhidari, i biri i Vladisalit
 Dimitri, i biri i Dolinës
 e veja Bogosava
 e veja Belosava

shtëpi 50	të veja 4	ispenxhe 1274	grurë barrë 15 45	thekër barrë 10 200	elb barrë 14 224	mel barrë 4 80
tagji barrë 15 210	lini 46	[taksa e] bletëve 30		mullinj të rajave 15		[taksa] perimeve 54
bidati i derrave 20	taksa e barit 250	taksa e druve 100			shuma 2953	

(275)

Fshati Grad^x, hassi i sanxhakbeut.

Vuku, i biri i Dimitrit
 Vuçiqi, i vëllai i tij
 Vukosavi, i biri i Radsavit
 Pokrajaçi, i biri i Radsalit
 Dobrashini, i biri i Ivanit
 Radaku, i biri i Novakut
 Vojati, i biri i Bozhiçit
 Pokrajaçi, i biri i Vukut
 Nikolla, i biri i Slavit
 Vukota, i biri i Stepanit
 Vuku, i biri i Dabzhivit

Radonja, i vëllai i tij
 Vuku, i biri i Bojkos
 Bozhidar Bojko
 Vukota, i vëllai i tij
 Vuçrini, i vëllai i tij
 Stepa, i biri i Vukashinit
 Vuksani, i biri i Radonjës
 Jovan Popi
 Vuja, i biri i Bogosavit
 Vuku, i biri i Radsalit
 Radiçi, i biri i Bozhiçit

Mladeni, i biri i Gjurashinit
 Vukota, i biri i Vukosalit
 Vuksani, i biri i Ivanit
 Stepani, i biri i Vukut
 Dobrani, i biri i Radiçit
 e veja Vukosava

Nikolla, i vëllai i tij
 Radonja, i biri i Bratos
 Radiçi, i biri i Ivanit
 Vuku, i biri i Vukashinit
 Ivani, i vëllai i tij
 e veja Olivira

shtëpi 32	të veja 2	ispenxhe 812	grurë barrë 15 450	thekër barrë 15 300	mel barrë 3 60	tagji barrë 10 140
lini 35	[taksa e] bletëve 10	[taksa e] perimeve 20		bidati i derrave 10		taksa e bari 160
taksa e druve 64		<i>shuma 2061</i>				

Fshati Ivrazha Giranxhi, hass i të sipërpërmendurit.

Stojani, i biri i Gjurkos
 Ostoja, i biri i Gropçës (Gropça)
 Todori, i biri i Prebilit
 Vukmani, i biri i Vukashinit
 Vuku, i biri i Vukotës

Priboja, i vëllai i tij
 Vukani, i biri i Ivanshit
 Petko, i biri i Dimitrit
 Radiçi, i biri i Dimitrit
 Bogdani, i biri i Radonës

(276)

Radsav Nikolla
 Vuku, i vëllai i tij
 Radosavi, i biri i Vukashinit
 Radiçi, i biri i Plajakut
 Radosavi, i biri i Bozhidarit
 Vukaçi, i vëllai i tij
 Vukota, i biri i Olivirit
 Novaku, i biri i Olivirit
 Vukça, i vëllai i tij
 Radiçi, i biri i Bogdanit
 Vuçrini, i biri i Bojës
 Stepani, i biri i Hralës (Hrala)
 Nikolla, i vëllai i tij
 Vuku, i vëllai i tij
 Bogiqi, i vëllai i tij
 Dobroi, i biri i Andrijës
 Vuku, i biri i Stepës
 Milashi, i biri i Bogdanit
 Miçati, i biri i Bozhidarit
 Vukosavi, i vëllai i tij
 Lale, i vëllai i tij
 Bozhiqi, i biri i Stepanit
 Radona Ivani

Todori, i biri i Dimitrit
 Radonja, i biri i Bojkos,
 Vuçrini, i vëllai i tij
 Vukashini, i vëllai i tij
 Radovaçi, i vëllai i tij
 Stepani, i biri i Vlakos
 Radaku, i biri i Novakut
 Lukaç Radsavi
 Vuçko, i biri i Rajkos
 Radsavi, i biri i Radiçit
 Nikolla, i biri i Ivanit
 Vladisavi, i vëllai i tij
 Milaçi, i biri i Bozhidarit
 Boga, i vëllai i tij
 Vuksani, i biri i Bojkos
 Dimitrashi, i vëllai i tij
 Vuksani, i vëllai i tij
 Nikolla, i biri i Dimitrit
 Vuksani, i biri i Radsalit
 Liçeni, i biri i Vukotës
 Dujçini, i biri i Ivanit
 Marku, i vëllai i tij
 Andrija, i vëllai i tij

Vladisav Petko Vuksani, i vëllai i tij
 Vuçrini, i biri i Pribës (Priba)
 Radiçi, i biri i Vujës
 Vukosavi, i vëllai i tij
 Radiçi, i biri i Radmilit
 Mlajini, i biri i Stepës
 Vukiqi, i vëllai i tij
 Vuksani, i vëllai i Vuçiqit
 Rajko, i biri i Stepanit
 Radiç Vlajko
 Vukça, i biri i Radsalit
 Radonja, i biri i tij
 Stepani, i biri i Vukosalit
 Vuçiq Petko
 Marko Siromah

Todori, i biri i Vujës
 Vukiqi, i biri i Vukashinit
 Radovani, i vëllai i tij

Radosna, i vëllai i tij
 Nikolla, i vëllai i tij
 Milovan Bogdani
 Andrija Siromah
 Radosna, i biri i Mladenit
 Radonja, i biri i tij
 Ivani, i biri i Stojës
 Stepani, i biri i tij
 Nikolla, i biri i Vujës
 Radonja Siromah

(277)

Vuçiq Gropça
 Radonja, i biri i Milaçit
 Todori
 e veja Stoja

Radonja Siromah
 Zhivko Siromah
 e veja Radosava
 e veja Radosava

Radonja Siromah, tjetër
 Branko
 e veja Olivira

shtëpi 92	beqarë 4	ispenxhe 2324	grurë barrë 20 600	thekër barrë 20 400	mel barrë 20 400	tagji barrë 20 280
lini 50	[taksa e] bletëve 30		mullinj të rajave: 1 30		[taksa e] perimeve 70	
bidati i derrrave 30	taksa e barit 460		taksa e druve 184	shuma 4858		

Fshati Komaran, hass i sanxhakbent.

Vukça, i biri i Radiçit
 Stepan Radsali
 Radiç Plajku
 Stepani, i vëllai i tij
 Radonja, i vëllai i tij
 Bogili, i vëllai i tij
 Vukashin Prepja Vuku, i vëllai i tij
 Rajak Içrebi Rajko, i vëllai i tij
 Vlajko, i vëllai i tij
 Vjuko, (Vojuko), i vëllai i tij
 Radsav Raça Radiç Radonja
 Vuku, i biri i Bozhdarit

Nikolla, i vëllai i tij
 Vuçrini, i vëllai i tij
 Radosna, i biri i Bogdanit
 Vuçrin Rajko
 Junak⁷³ Radonja
 Radiç Stoja
 Vuçrini, i vëllai i tij
 Vladisav Rajko
 Todori, i biri i Novakut
 Radonja Novaku
 Volja, i vëllai i tij
 Stepani, i vëllai i tij

73) Në faqen 132 është shkruar me shënjat diakritike Junak — يوناق

Vladisavi, i vëllai i tij
 Vuksani, i vëllai i tij
 Tadori, i vëllai i tij
 Vuksani, i vëllai i tij
 Lukaç Novaku
 Radosavi, i biri i Rajkos
 Radosna, i biri i Radiçit

Gjurashini, i biri i Radiçit
 Radonja, i biri i Milanit
 Ivani, i biri i Radiçit
 Radosna, i vëllai i tij
 Vukashini, i vëllai i tij
 Radonja, i vëllai i tij

(278)

Vukosav Stepiani
 Radashin Bogdani
 Radsav Radaku
 Stepiani, i biri i tij
 Radashin Radiçi
 Radashin Bogdani,
 Radonja Radsavi
 e veja Belosava
 Ivani, i biri i Vukotës
 Radivoi, i vëllai i tij

Vukosav Radiçi
 Radiç Radona
 Vuk Radsali
 Vuk Dimitri
 Mirko Nikolla
 Stepo Vukota
 Vukosav Gojçini
 e veja Vukosava
 Radsavi, i vëllai i tij
 Vukota Nikolla

Radiçi, i biri i Radonjës
 Vuku, i biri i Radsalit
 Radiç Bogdani
 Vukosav Rajko
 Vukosav Raça
 Jovan Rajko
 e veja Todora
 e veja Mara
 Bozhidar Bogdani

shtëpi 65	të veja 4	ispenxhe 1649	grurë barrë 20 600	thekër barrë 20 400	elb barrë 5 80	mel barrë 5 100
tagji barrë 25 350	lini 50	[taksa e] bletëve 51	mullinj të rajave: 3 90	[taksa e] perimeve 48		
bidati i derrave 20	taksa e barit 325	taksa e druve 130	<i>shuma 3894</i>			

Fshati Noshiq [Novshiq]^x, hass i sanxhakbeut.

Vuk Stepiani,
 Radiç Mioça
 Marko, i biri i tij
 Radak Pljaku
 Stepan Radiçi
 Marko Vukosali
 Nikolla, i biri i Radiçit

Tadori, i vëllai i tij
 Vuçrini, i biri i Vuksanit

Ivan Stepko
 Stilan Gjorgji
 Vukça, i biri i Prepjas
 Vukashini, i biri i Bezhanit
 Nikolla, i vëllai i tij
 Zhivko Nikaçi

(279)

Laja, i biri i Bozhidarit
 Pranushi, i biri i Vukut
 Gjurma Vuksani
 e veja Vukosava

Vuk Bojko
 Dimitrashin Pljaku
 Novak Vuçeta
 e veja Ruzha

shtëpi 21	të veja 2	ispenxhe 537	grurë barrë 5 150	thekër barrë 10 200	elb barrë 5 80	mel barrë 5 100
--------------	--------------	-----------------	-------------------------	---------------------------	----------------------	-----------------------

tagji barrë 10 140	lini 25	[taksa] bletëve 25	mullinj të rajave: 1 30	[taksa e] perimeve 24
bidati i derrave 10	taksa e barit 105	taksa e druve 42	<i>shuma 1479</i>	

Fshati Velika^x, hass i të sipërpërmendurit.

Bojko Ivani	Radiçi, i vëllai i tij	Vladisavi, i biri i tij
Stoja Bogdani	Radosna Radosavi	Vuku, i vëllai i tij
Radonja Mirosali	Vladisav Obradi	Radona Stepani
Nikolla Ivani	Dimitrashini, i biri i tij	Radani, i vëllai i tij
Vuku, i biri i tij	Bojko Rajko	Radosna, i vëllai i tij
Bjelovaç Dabzhivi	Radiç Boja	Bosa Dobrdo
Nikolla, i biri i tij	Bozhidar Gjuran	Radiçi, i vëllai i tij
Vladisavi, i vëllai i tij	Vuçrini, i biri i Stojës	Nikolla Radenko
Vuk Dobroi	Radmil Prebili	Radiçi, i vëllai i tij
Dimitri, i vëllai i tij	Rasha Prebili	Vukashini, i vëllai i tij
Bozhidar Radosna	Radsh Mladeni	Radonja Pljaku
Radonja Stoja	Bogoi, i vëllai i tij	Mileta Stepani
Oliviri, i dhëndri i tij	Radovan Bogosali	Radiç Bogoi
Rajko, i vëllai i tij		

(280)

Radonja, i vëllai i tij	Radonja Radosavi	Radosav Dobrosavi
Radosna Vuku	Radman Gjuranini	Melko Nikolla
Radsav Radini	Vukman Boja	Todori, i biri i Rajës
Zhivko Gjureti	Olivir Vuçrini	Bozhidar Nikolla
Bozhidar Çinqene	Radonja Radmili	Vuk Prebili
Stepani, i biri i Radosnës	Ivani, i biri i Rashës	Dragash Radivoi
Radashin Rajko	Lazër Radonja	Gjura Vuja
Nikolla Ugjlesha	Stepan Bogoi	Radiç Gjura
Radonja, i vëllai i tij	Gjurashin Mira	Vuçrini, i biri i Gjorgjit
Rajko Bogdani	Radonja Stepani	Vlajko Bojko
Bozhidar Radosna	Vuksan Dabzhivi	Vukman Nikolla
Vlajko Radiçi	Radashin Radivoi	e veja Bjela
e veja Spana	e veja Stoja	e veja Vojina
e veja Vukosava	e veja Olivira	

shtëpi 75	të veja 6	ispenxhe 1911	grurë barrë 25 750	thekër barrë 14 280	elb barrë 10 160	tagji barrë 20 280
--------------	--------------	------------------	--------------------------	---------------------------	------------------------	--------------------------

[taksa e] bletëve 45	mullinj të rajave:2 60	lini 51	[taksa e] perimeve 64	bidati i derrave 24
taksa e barit 475	taksa e druve 150	shuma 4250		

Fshati Rzhanica^x, hass i të sipërpërmendurit

Novak Stoja	Radiçi, i biri i tij	Bogdan Gosali
Laja Bogdani	Ivan Visali	Radiç Mirosavi
Bogdan Radsali	Pop Vuçrini	Radosna, i biri i tij
Vukosav Radiçi		

(281)

Radiç Stoja	Radiç Gluqanini	Radonja Radiçi
Prepjaç ⁷⁴ Dobrosavi	Radsavi, i vëllai i tij	Vuk Vladisavi
Bogdan Rajko	Radonja Siromah	Vladisav Ivani
Marko Radashini	Radosna Radona	Stepko Priça
Bojko, i vëllai i tij	Radonja Boja	Radakù, i vëllai i tij
Zhivko, i vëllai i tij	Radaç Radsavi	Vukashin Stojko
Milani, i vëllai i tij	Vukashin Dobrosavi	Mirashin Dobrosavi
Vuçeta Vladeni	Milan Stojko	Vukça Stepiani
Milani, i vëllai i tij	Radiç Boja	Radsavi, i vëllai i tij
Novok Spana	Vukashini, i vëllai i tij	Radosna Vuçko
Stepko Radosavi	Grubaçi, i vëllai i tij	Rada, i biri i Beles
Vuk Prenku	Radiçi, i vëllai i tij	Vukosavi, i biri i Vojinës
Bogdan Rajko	Stepa Vuku	Radiçi, i vëllai i tij
Radosna Radsavi	Radaku, i vëllai i tij	Vukosav Bogdani
Vuksani, i vëllai i tij	Vukota Vukça	Malçin Vidosavi
Radosna Oliviri	Ivanko Bojko	Rasha Radiçi
Vuku, i biri i Slavkos	Vukosavi, i vëllai i tij	Mirosav Radiçi
Radonja, i vëllai i tij	Stepani, i biri i Radonjës	Radonko Radaku
Radak Stepiani	Pop Mirosavi	Jovani, i biri i tij
Radiç Nikavaçi	Bojko Stoja	Radsav Nikolla
Vukashin Stepiani	Radosavi Siromah	Milovan Gordi
Radsav Vukashini	Radonja Radshi	Radash Govani
Gjurashini Siromah	Vukashin Radonja	Todori Siromah
Radosna Radiçi	Rajko Bogdani	Radonja Radsavi
Milani Siromah	Vukashin Bogdani	Onshi, i vëllai i tij

74) Leximi nuk është i sigurtë, sepse vetëm për dy germa janë shënuar shënjat diakritike **پرساچ**
Mund të lexohet edhe Prijaç, Pribaç, Pritaç — **پريپاچ، پريباج، پريتاج**. Këtë emër e kemi lexuar Prepjaç, duke u nisur nga fakti se ndeshim në këto materiale një emër të afër me të siç është si emri Prepja.

(282)

Radsav Novaku
e veja Spana
e veja Olivira, tjetër

Stepan Miokushi
e veja Olivira

Zhivko Radashi
e veja Bele

shtëpi 88	të veja 4	ispenxhe 2224	grurë barrë 30 600	thekër barrë 21 420	elb barrë 20 320	tagji barrë 25 350
lini 72	[taksa e] bletëve 64	mullinj të rajave; 3 90	[taksa e] perimeve 80			bidati i derrave 30
taksa e barit 440	taksa e druve 176	shuma 5166				

Fshati Mashnica^x, hass i të sipërpërmendurit

Pljak Dejani
Vukça, i vëllai i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Kali, i vëllai i tij
Radashi, i vëllai i tij
Vladisavi, i vëllai i tij
Todor Bogosavi
Nikolla Vukashini
Dabko, i biri i Tihodarit
Stojan Todori
Dobrosh Petko
Vdolja, i vëllai i tij
Martin Radsavi
Pop Milani
Stepani, i vëllai i tij
e veja Stoja

Radosna, i biri i tij
Strana, i biri i Radonjës
Nikolla Radashini
Rajan Milashini
Vukça Brisavi
Bozhidar Ivani
Vukota Pljaku
Dobrashin Radsavi
Zhivko, i vëllai i tij
Stepani, i vëllai i tij
Dobrashini, i vëllai i tij
Todori, i vëllai i tij
Ivan Gjurashini
Radsav Tihodari
Gjurash Bozhani
e veja Vlada

Radonja, i vëllai i tij

Vukashin Bogdani
Vojnoja, i vëllai i tij
Cvetko Tihodari
Vukça, i biri i tij
Stepan Novaku
Olivir Radashin
Vuk Bozhidari
Radiç Miladini
Radsav Radosna

Ivaneshi, i vëllai i tij
Petko Bogdani
e veja Visha

(283)

shtëpi 42	të veja 3	ispenxhe 1068	grurë barrë 7 210	thekër barrë 10 200	elb barrë 4 640	mel barrë 5 100
tagji barrë 10 140	lini 40	mullinj të rajave: 2 30	[taksa e] perimeve 46			bidati i derrave 15
taksa e barit 210	taksa e druve 84	shuma 2783				

Fshati Gorna ulutina, hass i sanxhakbeut

Vlajko Nikolla
Pjeçi (Pjaç)⁷⁵, i biri i Petkos
Todor Stepani Vukosav Gjorgji
Priça, i biri i Radonjës

Zhivko, i vëllai i tij
Zagraç Andrija
Prodan Radiçi
Radaçi Siromah

75) Asnjëherë nuk e gjejmë të shkruar në shënjat diakritike— ساج . Mund të lexohet gjithashtu edhe Petaç, Penaç— پتاچ، پتاچ etj.

Radosna Nikariqi
 Raça, i biri i Lubës (Luba)
 Radosna Vokshi
 Vukashin Dobruli
 Bozhidar Radani
 Radmil Dimitri
 Bogdan Radmili
 Radak Prabio
 Vuk Radiçi
 Branko Milanko
 Vukça Belosava
 Vuksan Dimitri
 Petko Vukota
 Ivan Radiçi
 Bozhidar Vuksani
 Radonja Vuku
 Nikolla, i biri i Novakut
 Stepan Radani
 Vukosav Radiçi
 Bozhidar Vuja
 Nikolla Novaku

Stoimil Dobrashini
 Radiçi, i biri i Dabkos
 Marash Petri
 Gjura, i vëllai i tij
 Vukça, i vëllai i tij
 Radiçi, i vëllai i tij
 Bogosavi, i vëllai i tij
 Radenko, i vëllai i tij
 Vuksan Rajko
 Nikolla Vuku
 Stojko Virloviqi
 Novak Gjorgji
 Zhivko, i biri i tij
 Radiç Prebili
 Bogosav Stojko
 Radsav Rajko
 Lazër Radiçi
 Stepan Boroçi
 Vukman Boimili
 Oliviri, i vëllai i tij

(284)

Vukça Priça
 Vukosav Vuja
 Radiç Bozhidari
 Vuk Govedar
 Radiç Vuku
 Bozhidar Radovani
 e veja Janka
 e veja Dança
 Vuku i biri i Stanilit
 Todor Prebili
 Vukça, i vëllai i Bozhidarit
 Gjura, i biri i Blajkos
 Vuksan Radiçi Olivir Radiçi
 Zagoraçi, i biri i Radiçit
 Novaku, i biri i Ivanit
 Gjura, i biri i Prebilit
 Radonja Vidomiri

Vukashini, i biri i Popit
 Vukiqi Siromah
 Vukça Priça
 Radiç Dobruli
 Radiç Stojko
 e veja Vukosava
 e veja Todora
 Nikolla, i biri i Stojkës
 Vukça, i biri i Stepanit
 Vukashini, i vëllai i Gjurës
 Radoi, i biri i Dimitrit
 Stosav Dobrashini
 Vukoslav Gjura
 Vukça, i biri i Petkos
 Vukmiri, i biri i Radiçit
 Bozhidari, i vëllai i tij

shtëpi 80	të veja 4	ispanxhe 2024	grurë barrë 20 600	thekër barrë 20 400	elb barrë 5 80	tagji barrë 10 140
mel barrë 10 200	lini 40	mullinj të rajave: 2 30		[taksa e] perimeve 60		bidati i derrave 20
taksa e barit 400	taksa e druve 160		<i>shuma 4154</i>			

Fshati Luzi, varet nga Plava; hass i sanxhakbeut.

Pribo, i biri i Nikës
 Radonja, i biri i tij
 Vukaçi, vëllai i tij
 Radiçi, i biri i Nikës
 Radoslavi, i biri i Novakut
 Rahona, i vëllai i tij
 Belovaçi, i biri i Radiçit
 Dobriilo, i biri i Radiçit
 Dobriilo, i biri i Sojkos
 Vuçrini, i vëllai i tij
 Vukiqi, i biri i Milofiçit

Radaku, i biri i tij
 Jovani, i biri i Radonës
 Vuku Siromah
 Radonja, i biri i tij
 Popi, i vëllai i tij
 Radona, i vëllai i tij
 Vuksha, i biri i Mladenit
 Vuksha, i biri i Mladenit
 Miloshi, i biri i Dobrilos
 Radivoi Siromah
 Vukashin ...

(285)

Tole Siromah
 Novaku, i biri i Bogosalit
 Novaku, i biri i Bogosalit
 Dabko, i biri i Radsalit
 Zagoraç Medona
 Petko, i biri i Petkos
 Bojko, i vëllai i Stepanit
 Novaku, i biri i Radovanit
 Milovani, i biri i Novakut
 e veja Beloja

Vuçheta, i biri i Dobrafiçit
 Raposhi, i vëllai i tij
 Rajini,⁷⁶ i vëllai i tij
 Radovani, i vëllai i tij
 Vidaku, i vëllai i tij
 Stojani, i vëllai i tij
 Stajko, i biri i tij
 Vukota, i biri i Vukiqit
 Radovaçi, Siromah
 e veja Spança

shtëpi 38	të veja 2	ispexhe 962	grurë barrë 10 300	thekër barrë 5 100	elb barrë 5 80	mel barrë 5 100
tagji barrë 10 140	lini 41	[taksa e] bletëve 40	[taksa e] perimeve 40	mullinj të rajave: 2 30		
bidati i derrave 15	taksa e barit 190	taksa e druve 76	<i>shuma 2112</i>			

Fshati Dolina Ulutina^x, varet nga Plava; hass i sanxhakbeut.

Pilak Bloça
 Vukja, i biri i Stepanit
 Vuku, i biri i Breshalit
 Volja, i vëllai i tij
 Stepani, i biri i Gjurashinit
 Radonja, i vëllai i tij

Bozhidari, i biri i Borofiçit
 Ribaç, i vëllai i tij
 Vukosavi, i biri i Radonës
 Vuçko, i biri i Radoshinit
 Bransavi, i biri i Dobrosavit
 Gjura, i biri i Stepanit

76) Në faqen 7 është shkruar me shënjat diakritike Rajin — راین

Vukashini, i biri i Radoshinit
 Oliviri, i biri i Borofiçit
 Çepa, i biri i tij
 Radiçi, i biri i Pavlos
 Radosavi, i vëllai i tij
 Vukaçi, i biri i Todorit
 Vukani, i vëllai i tij

Prebili, i biri i Vukut
 Rajko, i biri i Gjorgjit
 Pljaku, i vëllai i tij
 Radonja, i vëllai i tij
 Vuku, i vëllai i tij
 Gjuro, i biri i tij

(286)

Vukmiri, i biri i tij
 Stepan Murzaku
 Stepiani, i biri i Vukashinit
 Bazhidari, Siromah
 Radosna, i vëllai i tij
 Vukashini, i biri i Mirosalit
 Stepiani, i biri i Rados
 Vukashini, i biri i Vladisavit
 Radosavi, i biri i tij
 Radiçi, i vëllai i tij
 e veja Ermenika
 e veja Doja

Radonja, i biri i Andrijës
 Vuku, i biri i Andrijas
 Gjuraçi, i vëllai i tij
 Bogdani, i vëllai i tij
 Stepiani, i biri i Brankos
 Vukosavi, i vëllai i tij
 Vukashini, i vëllai i tij
 Vukosavi, i vëllai i tij
 Bozhidari, i biri i Vukut
 Bjelovaçi, i biri i Rajkos
 e veja Todora
 Radiçi, i biri i Novakut

shtëpi 46	të veja 3	ispenxhe 1168	grurë barrë 10 300	thekër barrë 11 220	elb barrë 5 80	tagji barrë 15 210
mel barrë 3 60	lini 50	[taksa e] bletëve 43	mullinj të rajave: 1 30		[taksa e] perimeve 34	
bidati i derrave 35	taksa e barit 230	taksa e druve 92		<i>shuma 2551</i>		

gjithësej vilajeti i Plavës, së bashku me ispenxhen, nijabetin, të ardhurat e liqenit dhe prodhimet e tjera: fshatra: 15, shtëpi: 1081, beqarë: 23, të veja: 48, të ardhura: 70.684.

(287)

NAHIJA IZLA RJEKA, VARET NGA PLAVA; NGA KAZAJA E BIHORIT.

Fshati Çëranshkova, varet nga e sipërpërmendura; hass i të sipërpërmendurit.

Ivani, i biri i Dabzhivit
 Stojan Ivani
 Radiçi, i vëllai i tij
 Vuçeta, i biri i Radosalit
 Vukosavi Siromah Radiç Dabzhivi
 Bozhidari, i biri i Gjorgjit
 Nikolla, i vëllai i tij

Todori, i biri i Rajkos
 Kisha, i biri i Ilias
 Vuku, i biri i Rajkos
 Oliviri, i biri i Todorit
 Novaku, i vëllai i tij
 Petko, i biri i Ivanit
 Novaku, i biri i Radonjas

(314)

NAHIJA E PODGORICËS

Fshati Podgorica^x, është varoshi i kalasë së Depedegjenit; hass i të sipërpërmendurit.

Vuku, i biri i Radeshit
Gjurashi, i vëllai i tij
Dabzhivi, i biri i Medojës
Gjura, i biri i Bogosalit
Pop Novaku
Gjurashi, i biri i Niqshës (Niqsha)
Pop Aleks
Petko, i biri i Vukotës
Petri, i biri i Radoshit
Nikaçi, i biri i Vuksanit
Novaçi, i biri i tij
Stepko, i biri i Mlyshit
Stepko, i biri i Rajanit
Stoja, i biri i Popit
Nikolla, i biri i Dujçoviçit
Rajko, i biri i Bogosalit
Nikolla, i vëllai i tij
Ilija, i biri i Gjurës
Nikolla, i biri i Milkos
Stepaniçi, i biri i Radkos

Vuksani, i biri i Prematit (Premati)
Janku, i biri i Bojkos
Veleci, i biri i tij
Vuksani, i vëllai i tij
Pop Vojko
Radko, i biri i Mladenit
Ivani, i biri i Radovaçit
Melko, i biri i Stojës
Bojiç, i biri i Bozhidarit
Melko, i biri i Bralinit
Radiçi, i biri i Nikollës
Gjurko, i biri i Bogosalit
Radko, i biri i Vladimirit
Momçili, i biri i Vukashinit
Radmani, i biri i Dabkos
Vladaçi, i biri i Dimitrit
Dabaçi, i biri i Lapkos
Vulku, i biri i Radsalit
Vuçeta, i biri i Zagoraçit
Bozhidari, i biri i Radenkos

htëpi 40, të ardhura 3500

Fshati Kurilo^x, Varoshi i vetë kalasë së Zhabjakut

Nikolla, i biri i Ilias
Dubko, i biri i Nikollës
Nikolla, i biri i Mioças
Petko, i biri i Radovanit
Vojko, i biri i Nikës

Iliashi, i biri i Novakut
Nikolla, i biri i Mirkos
Mladeni, i biri i Vishës
Lala, i biri i Dajçës
Nikëza, i biri i Gjuriçit

(315)

Vuço, i biri i Vlatkos
Petri, i biri i Bozhidarit
Mirko, i biri i Radiçit
Dabzhivi, i biri i Mirkos
Pepa, i biri i Kuçit
Vukaçi, i biri i Dabos
Mirash Shallari

Nikolla, i biri i Stajkos
Dabzhivi, i biri i Brankos
Vulku, i biri i Petrit
Petko, i biri i Stojanit
Gjuraçi, i biri i Previnit
Ivani, i biri i Mlyshit
Niqsha, i biri i Stepanit

